

# **QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT**

***STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

**"THE GLOBAL LEADERS" sh.p.k.**

"Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

"Statut" është Statuti i shoqërisë;

## **KREU I**

### **THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA**

#### **Neni 1**

##### ***Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit***

- 1.1 Sot me datë 20.05.2020, ne, themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "The Global Leaders" SH.P. K
- 1.2 Themeluesit e shoqërise janë:  
Florë Cerku, 22.08.1986 me nr ID. I65822068L lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardin Bajram Curri, njësia administrative nr.5

#### **Neni 2**

##### ***Objekti***

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ofrimi I shërbimeve në fushën e konsulencës dhe këshillimeve për planifikimin, hartimin dhe zbatimi I programeve të marketingut në fusha të ndryshme, planifikimi I fushatave publicitare ne media audiovizive dhe të shkruara, shfrytëzimi I publicitetit dhe I shërbimeve të internetit në territorin e Shqipërise dhe territorë të tjera.

Ofrimi I shërbimeve për sipërmarrësit, tregtarët, organizatat fitimprurëse ose jo fitimprurëse, shërbimet publike, qeverisja vendore, shoqatat bashkëpunuese dhe profesionale në territorin Shqiptar dhe jashtë saj, organizatat politike, kulturore dhe në përgjithësi çdo person privat ose juridik në fushat e komunikimit, reklamimit dhe marrëdhënieve me publikun, hulumtimin e tregut, për promovimin e shitjeve online, fushatat e marketingut përmes internetit, programet e marketingut dhe trajnimin e drejtuesve.

Konceptimi, dizajni, redaktimi, prodhimi dhe mirëmbajtja e materialeve të komunikimit elektronik. Web dizajn, Web Hosting, ngritje dhe mirëmbajtje e rrjetave sociale në internet, marketing online. Sherbime shitje – blerje online, sherbim I reklamave grafike online dhe offline, shërbimet e promovimit të produkteve, prodhim logosh, printime, publikime ne gazetë, revistë dhe online.

Organizimi I eveneve, konferencave, trajnimeve në funksion të promovimit të kompanisë dhe prodhimin vizual të produkteve promocionale lidhur me aktivitetin për mbarëvajtjen e kontratës së marketingut me klientin.

### **Neni 3**

#### ***Kohëzgjatja***

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat

### **Neni 4**

#### ***Selia***

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi: Bajram Curri, Pallatet Agimi. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërise me miratim të organeve kopetente edhe jashtë vendit.

4.2 Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është : [www.theglobaleaders.com](http://www.theglobaleaders.com)

4.3 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:  
[info@theglobaleaders.com](mailto:info@theglobaleaders.com)

### **KREU II**

#### ***Kapitali***

### **Neni 5**

#### ***Kapitali Themeltar***

Kapitali themeltar fillestar I shoqërisë është 100 lekë, I përbërë nga një kuotë nga kontributi I ortakut të vetëm:

**Florë Cerku, zotëruese e 100% të kapitalit themeltar.**

## Neni 6

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar per këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 7

Transferimi I kapitalit Kuotat e kapitalit të nje shoqerie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

## Neni 8

### **Organi vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të percaktuara në ligj.

*Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:*

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i llikuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat epermendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërise;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërise nuk mund të veprojë si përfaqesues i ortakëve në asamblene e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njejtin rend dite.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës I te këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë me shumë se 30 per qind te kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për

Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## Neni 11

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërise.

*Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

*Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.*

## Neni 12

### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim per:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njejtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

12.3 Personat e mëposhtem caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emerimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

#### **- Florë Cerku**

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

*Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:*

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së-veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së-përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertefikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërine, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të perballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 151) 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- 15.1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në terësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, perfundimet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me perjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standaret profesionale, sipas pikave 1 e 2 të ketij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga

kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

15.4 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividende;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV

##### Viti finansiar-ekspertët

###### Neni 16

###### Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

###### Neni 17

###### Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për

nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka.

## Kreu V

### Prishja —riorganizimi i shoqërisë

#### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

*Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në perputhje me pikën 3 te nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës; Ne këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19

##### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjës së Përgjithshme të Asamblesë Së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

## Neni 20

### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.


## Neni 21

### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## **ORTAKËT E SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“The Global Leaders” sh.p. k



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "FLORË CERKU". It is written above a horizontal line, with a large, stylized signature below it.

Florë Cerku

(administrator)